



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.12/2017

Prishtinë, më 14 shkurt 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Munguan: Frashër Krasniqi, Mytahir Haskuka dhe Mirjeta Kalludra.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Skënder Reçica, ministër i MPMS-së, Dritona Ademi, këshilltare politike, MPMS, Bahri Xhaferi, MPMS, Andin Hoti, deputet, Burim Tahiri-IAP, Fatmir Tasholli dhe Hysen Ajeti, Sindikata e ish-Policisë së Kosovës, Ndue Kalaj, SPAK, Rafet Azemi, SPAK, Lumturie Bekaj, Kosva Info, Valbona Bytyçi, Ekonomia Online, Teuta Prekazi, UN Human Rights.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite:**

1. Raportim në komision- i ftuar ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skënder Reçica;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të fundit;
3. Njoftim lidhur me shqyrtimin e peticioneve nga grupi punues i komisionit;
4. Të ndryshme.

## **1. Raportim në komision - i ftuar ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skënder Reçica**

**Kryetarja**, falënderoi z. Skënder Reçica, ministër i MPMS-së, që iu ka përgjigjur ftesës së komisionit dhe tha se ministri është ftuar lidhur me kërkesën e Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës dhe Sindikatës së Pavarur të Organeve për Punë të Brendshme të Kosovës, që kanë propozuar ndryshimet dhe plotësimet në ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

**Skënder Reçica**, ministër, tha se prej se e ka marrë detyrën, shpeshherë është ballafaquar me pamundësi të zbatimit të ligjit në praktikë, kemi filluar hapat e parë për ndryshim-plotësim të këtij ligji, dhe brenda këtij viti, kemi paraparë t'i hyjmë reformës së sistemit pensional të Kosovës, përfshirë edhe kornizën ligjore, hartimin e ligjit të ri të sistemit pensional në vend. Ai tha se sistemi pensional në Kosovë ka pasur ndërprerje të plotë në fund të vitit 1998.

Si ministri, kemi takuar dhe kemi marrë shumë shkresa nga qytetarët, kemi analizuar legjislacionin në fuqi dhe kemi vërejtur se vendit i duhet një reformë pensionale, ku do të përfshiheshin në një ligj të përgjithshëm të gjitha skemat pensionale dhe ku pragu prej 15 vitesh të rivlerësohet, por janë duke u analizuar edhe modalitetet të tjera.

MPMS ka shtyrë në agjendën legjislative të vitit 2018, koncept-dokumentin për menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve dhe tashmë ka formuar grupin punues për hartimin e këtij koncept-dokumenti, i cili do t'i paraprijë projektligjit të ri të pensioneve që do të rregullojë edhe shumë çështje të tjera.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, tha se kur ministrat ftohen në raportim në komision, paraprakisht do të duhej ta dërgonin një raport me shkrim, që ta analizojmë dhe mos t'i përsërisim ato se çka janë bërë. Ajo tha se ka shumë kërkesa nga familjarët e personave të zhdukur, që ky ligj të ndryshohet dhe me padurim po pritet një nismë e tillë. Si ministri, çka keni paraparë, përveç plotësim-ndryshimit të këtij ligji? Dihet që deri më tani familjet e të pagjeturve nuk kanë gëzuar beneficione, siç i gëzojnë kategoritë e tjera të dala nga lufta, nga familjarët e

dëshmorëve, invalidëve dhe kategorive të tjera të dala nga lufta, na paraqitet si shqetësim skema pensionale, duke filluar nga ata që kanë pasur pensione kontributdhënëse. Kemi raste që kanë punuar me 40 vite dhe vjen një moment kur një prind duhet të zgjedhë se a do të marrë pensionin e kontributdhënies apo do ta marrë pensionin për djalin apo vajzën dëshmor. Por, edhe më shqetësueses është kur një prind ka dy apo tre dëshmorë dhe gëzon vetëm një pension si familje e dëshmorit. Çështje tjetër, që po ballafaqohemi përditë është zbatimi i ligjit të punës në sektorin privat, dhe për këtë, a është problemi te numri i vogël i inspektorëve apo mosfunksionimi i Inspektoratit në sektorin privat? Të gjithë duhet të angazhohemi që të ndryshojmë gjendjen në sektorin privat, theksoi ajo.

**Saranda Bogujevci**, tha se kur të procedohet projektligji për skemat pensionale në Kuvend është mirë të vijë edhe në komisionin tonë, sepse ka të bëjë me të drejtat e njeriut.

**Albulena Balaj- Halimaj**, tha se është e nevojshme të ndryshohet i tërë ligji, por për shkak të buxhetit, ka filluar në nene të caktuara.

Është e papranueshme nëse stazhi kërkohet prej 15 viteve, para vitit 1990. Kjo është e tepërt, sepse në vitet 1990-1992, i kanë larguar nga puna dhe përpos dëmit që u është bërë në atë kohë, po i dënojmë edhe tani. Kjo duhet të ndryshohet dhe iniciativa e ministrisë është e mirë dhe me vullnetin e ministrit besoj se do të realizohet.

**Kryetarja**, tha se janë konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut lidhur me stazhin që kërkohet prej 15 viteve dhe do të duhej ndryshuar dhe rregulluar kjo çështje.

**Teuta Haxhiu**, shqetësim i të gjithëve është ajo se kontributi u njihet vetëm atyre që kanë punuar 15 vite dhe kanë paguar kontribute. Besoj që shumë shpejt do t'u njihet stazhi edhe punëtorëve të arsimit të viteve të 90-ta, që kanë dhënë një kontribut të madh dhe një sakrificë, por jemi vonuar në këtë drejtim. Ajo tha se di raste kur një personi të verbër, iu ka ndaluar pensioni, sepse është vënë në lajthitje për të zgjedhur si nënë e dëshmorit apo e dy dëshmorëve, se cilin pension ka për ta marrë. Çka është bërë në këtë drejtim për t'i evituar këto pengesa?

Më tej, ajo u interesua të dijë çka ka bërë ministria për ta ndryshuar ligjin për personat e zhdukur dhe ministria të ndër marrë veprime për të evituar shkeljet e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat.

**Andin Hoti**, pajtohet që projektligji për skemat pensionale të kalojë edhe nëpër Komisionin për të Drejtat e Njeriut, po ashtu duhet të ndryshohet ligji që i obligon familjet që kanë dëshmorë në marrjen e pensionit për njërin dëshmor. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut dhe kjo është e rëndë për ato familje. Po ashtu, i intereson të dijë lidhur me të zhdukurit, nëse si ministri keni hartuar plan të veprimit, për skemat sociale të tyre, sepse dihet që janë 1600

familje të të zhdukurve dhe beneficionet e përafërta që i kanë kategoritë e tjera të dala nga lufta, duhet t'i gëzojnë ato benefite edhe këto familje.

Po ashtu, tha se në ligjin për persona të zhdukur duhet të ndryshohet edhe neni 6, paragrafi 3, ku thuhet se një familjar i personit të zhdukur ka të drejtën e autorizimit për të menaxhuar pronën dhe pasurinë e personit të zhdukur dhe në një formë kushtëzohet që personin e zhdukur ta shpallë të vdekur, në mënyrë që të trashëgojë pasurinë e tij, thuajse asnjë familjar nuk e ka këtë vullnet, të shpallë të vdekur familjarin e tyre, dhe besoj, si komision, duhet ta ndryshoni këtë nen.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se edhe më parë, kur ishte ministri në komision, ka qenë kërkesë që të dihet se farë do bëhet me familjarët e të zhdukurve dhe të dëshmorëve, ku atyre po u

mohohet e drejta që të gëzojnë pensionin kontributdhënës, por edhe pensionin apo ndihmësen nga shteti për fëmijën apo familjarin e tyre të zhdukur apo të vdekur.

Po ashtu, ajo u interesua të dijë se çka do bëhet me kategorizimin e listës së pagave të veteranëve të luftës. Sa i përket sektorit privat, shfaqti brengën për gjendjen aspak të mirë në këtë sektor, ku kemi shkelje të shumta të të drejtave të të punëtorëve. Ajo, po ashtu, pyeti ministrin: a ka ndërmarrë ministria hapa konkretë që personat e moshës së shtyrë mos të jenë të detyruar të paraqiten për lajmërim në zyrat e administratës së ministrisë, për t'u verifikuar çdo 6 muaj lidhur me pensionin?

Lidhur me peticionin, i cili është objekt shqyrtimi në këtë mbledhje, tha se është kërkuar ndryshimi i ligjit për skemat pensionale në Kosovë. Çka do të bëhet me të gjithë ata punëtorë që kanë punuar në vitet 1990-1999?

Ajo pyeti edhe në lidhje me procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të zhdukurit: a është duke punuar ministria apo po mbetet që këtë ta bëjë komisioni?

**Kryetarja**, tha se ne kemi marrë peticionin nga sindikatat, por ky ligj për të cilin po diskutojmë, është kompetencë e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Këtu jemi vetëm të konstatojmë se a janë shkelur të drejtat e njeriut me këtë ligj dhe a është diskriminues, theksoi ajo.

**Ndue Kalaj**, kryetar i Federatës Sindikale të Shërbyeseve Civile të Kosovës, falënderoi komisionin për ftesën.

Si sindikatë, kemi shqetësime për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe kemi cekur dy fakte, e para tash e 18 vite nuk arrihet që të nxirret një akt ligjor për përcaktimin e kushteve dhe

kritereve për pranimin e stazhit të viteve 90-ta. Edhe ILO, ka konstatuar se largimi i punëtorëve ka qenë vendim diskriminues dhe politik, i kemi bërë kërkesë edhe Avokatit të Popullit, i cili pas hulumtimeve që i ka bërë ka konstatuar se dëbimi i punëtorëve shqiptarë nga puna është bërë në baza politike, kemi kërkuar të përgatitet një akt ligjor nga qeveria dhe të përcaktohen kriteret kush çka duhet të plotësojë që të rregullohet çështja e stazhit të punës së viteve 90-ta. Ne kërkojmë që të nxirret një akt ligjor dhe të dihet se Kosova vitet 90-ta konsideron vite të okupimit klasik, çështja e dytë ka të bëjë me ligjin mbi skemat pensionale të financuara nga shteti dhe jemi për kriterin e moshës 65 vjeçare. Mirëpo, kur thuhet se duhet të këtë stazh kontributdhënës sipas ligjit të ish-KSAK, po sipas ligjit mbi sigurimin pensional e invalidor të ish-KSAK të vitit 1983, dhe një diskriminim i madh është tash mes atyre që kanë mbetur në punë dhe atyre që janë larguar me dhunë nga puna. Edhe në nenin 8, paragrafi 6 thuhet se stazhi kontributdhënës për vitet 1989 -1998, do t'u pranohet punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve, që kanë punuar me sistemin e Republikës së Kosovës.

Në ligj figuron fjala “të tjerët”, por kush mund të jenë ata të tjerët, kemi pyetur, por nuk e dinë kush janë të tjerët, nuk jam kundër punëtorëve që kanë punuar në arsim e shëndetësi, por, pse t'u mohohet kategorive të tjera që kanë punuar me këtë sistem, si BSPK etj., dhe sot nuk u pranohet kontributi i tyre.

Për këtë arsye, kemi konsideruar se këto dy nene janë nene diskriminuese dhe shkelin të drejtat e njeriut. Shkelje tjetër është se vetëm para vitit 1991, personave që pensionohen ua pranojnë fakultetin, nuk di ku e kanë marrë atë dispozitë ligjore dhe urgjentisht këto nene të ndryshohen sa më parë, pa e pritur reformën ligjore. Këto kanë mundësi të bëhen me një ndryshim-plotësim të dy tri neneve, të cilat e bëjnë gjendjen reale.

**Skënder Reçica**, tha se familjarët e personave të pagjetur e marrin një kompensim. Si ministri, kemi iniciuar ndryshimin-plotësimin e ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti vitin e kaluar dhe kemi dërguar në Qeveri propozimet, kemi kërkuar largimin e ndalesës për pensionet e dyfishta për përfitues të mundshëm që mund të përfitojnë mbështetje apo pensione nga ligji për kategoritë e dala nga lufta. Ligji aktual i skemave pensionale, në shumë raste, diskriminon qytetarët, sa i përket moshës dhe stazhit. Pra, si ministri, jemi të obliguar ta zbatojmë këtë ligj ashtu si është. Këto kanë qenë arsyet që kemi iniciuar grupin punues të bëjmë reformën e sistemit pensional. Lidhur me këtë, mendojmë se si koncept, para vjeshtës, ta përcjellim për miratim në Qeveri dhe të fillojmë draftimin e ligjit dhe të gjitha këto që u thanë këtu t'i eliminojmë me ligjin e ri, përfshirë uljen e stazhit.

Ai tha se me ligjin për kategoritë e dala nga lufta, familjarët paguhen për dëshmorët, dhe nëse është më shumë se një dëshmor në një familje, ekziston një diferencë.

Sa i përket mbikëqyrjes së të drejtave të punëtorëve, jemi në përpilim të ligjit të ri të punës, dhe si ministri, jemi duke punuar shumë që ta fuqizojmë rolin e Inspektoratit të Punës. Po ashtu, jemi duke e bërë ligjin e ri për Inspektoratin e Punës, dhe këtë vit, kontingjentit të inspektorëve do t'i shtohen edhe 10 inspektorë të rinj.

Kemi dërguar në Qeveri rregulloren për kategorizimin e veteranëve të luftës, dhe mbas miratimit në Qeveri, duhet të bëhet edhe komisioni i ri. Sa i përket lajmërimit të pensionisteve çdo 6 muaj në zyrat e pensioneve, jemi duke bërë ndryshimin e udhëzimit administrativ për të shikuar mundësinë që kjo masë të largohet dhe të zëvendësohet me masa të tjera, pra duhet të gjejmë modalitete se si është zgjidhje më e mirë dhe e drejtë.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, ju përgëzoj për nismën që e keni marrë, sepse u është bërë një e padrejtë familjeve të dëshmorëve dhe kontributdhënësve, të cilëve u janë bërë ndalesat dhe kushtëzimet. Më intereson të di, a do bëhet kompensimi i periudhës së ndalesës deri në momentin kur do të bëhet ligji?

**Skënder Reçica**, tha se e dimë që ju është bërë një e padrejtë, me një vendim të vitit 2011 dhe me një vendim të Qeverisë të vitit 2014, dhe brenda muajit të parë, kemi shfuqizuar ato vendime që nuk ka qenë e lehtë dhe u kemi mundësua qytetarëve të drejtat që ju takojnë me ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, veteranëve dhe kategorive të tjera. Në praktikë, kjo çështje po bëhet realitet dhe tashmë të gjitha ato kategori që përfitojnë nga ky ligj kanë filluar të aplikojnë për të drejtat e tyre.

**Hysen Ajeti**, (Sindikata e ish-Policisë), tha se ky ligj i cili aktualisht është në fuqi është diskriminues, sepse bën dallime të punëtorëve dhe ne kemi kërkuar ndryshimin e nenit 8 të këtij ligji për skemat pensionale dhe kemi menduar që vetëm për këtë do të diskutohet këtu.

Neni i lartpërmendur do të duhej që të evitohet sa më shpejt.

**Rafet Hasani**, sekretar në SPAK, tha se të gjithë të larguarve nga puna në vitet 90, t'u njihet stazhi i barabartë. SPAK e ka evidencën që ia ka dërguar ministrit të mëparshëm dhe do t'ia dërgojmë edhe komisionit tuaj. Ka mbetur një numër i vogël për t'ua pranuar stazhin punëtorëve të viteve 90-ta.

**Teuta Haxhiu**, pyeti: a kanë të dhëna të sakta, sa është numri i këtyre punëtorëve dhe të na i dërgoni numrin e saktë tek administrata.

**Lirije Kajtazi**, tha se të gjithë e kemi pritur këtë ndryshim-plotësim të këtij ligji dhe ulja e pragut për njohjen e stazhit të punës, kjo do të duhej të rregullohet sa më parë që është e mundur, sepse të gjithë e konsiderojmë si të metë të ligjit aktual.

Ajo, në vazhdim, pyeti: a keni propozim konkret lidhur me këtë çështje.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se deri sa thash se ka ankesa të punëtorëve të arsimit të cilët nuk e gëzojnë këtë të drejtë dhe ata shkojnë me procedura gjyqësore për të pasur të drejtën e gëzimit të njohjes së stazhit, nuk e di sa është e vërtetë kjo.

Kuptova nga ministri se është duke u punuar koncept-dokumenti, derisa është një kohë e gjatë e punës për një koncept-dokument, çfarë mund të bëhet në nenin 8 për ndryshim-plotësimin e ligjit për skemat pensionale, ku ende i referoheni një ligji të një krahine dhe nuk po mund të paramendoj se ndodh, a është e sigurt kjo?

Dua të di nga ministri lidhur me kërkesën e sindikatës se a është ne rregull dhe se ky peticion a është i bazuar pikërisht në këtë nen dhe paragraf?

**Ndue Kalaj**, është fakt shumë i mirë që ministri e pranon publikisht se ky ligj diskriminon. Një ligj që diskriminon duhet me ndërmarrë hapa për eliminimin e këtij diskriminimi, sepse ai ligj nuk bën të ekzistoj. Sa i përket të tjerët as Kushtetuta e askush nuk e përcakton të tjerët për të bërë. Pyes ministrin, jo prej se është në detyrë, por prej vitit 2015, a ka ndonjë kategori - të tjerët, që i përmenda, që kanë punuar për Republikën e Kosovës, e që iu ka pranuar stazhi prej asaj date, a kanë mundur ta zbërthejnë në mënyrë institucionale-juridike se çka është kuptuar me shprehjen “të tjerët”?

**Skënder Reica**, shprehja diskriminim është term i gjerë, me ligjin aktual shumë palë iu mohohen të drejtat e tyre. P ashtu, u bë pyetje pse deri në vjeshtë koncept-dokumenti, aq shumë ka punë dhe aq shumë prek ky ligj edhe në ligjet e tjera dhe na duhet një kohë bukur e gjatë për të bërë një analizë të mirëfilltë.

Ai tha se arsyeja pse nuk e kemi prekur nenin 8 të këtij ligji, qëndron në analizat fillestare nga të cilat rrjedh se, sikur pragu të ulej prej 15 në 10 vite, kostoja e buxhetit vetëm në atë pjesë kap shifrën mbi 35 milionë euro. Nuk them se nuk po duam ta bëjmë këtë, por, për secilin veprim që e bëjmë kemi obligim për ta ruajtur stabilitetin financiar të vendit.

## **2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit**

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24 janar dhe 1 shkurt 2018, u miratuan pa vërejtje.

## **3.Njoftim lidhur me shqyrtimin e peticioneve nga grupi punues i komisionit,**

Kryetarja, konstatoi se përfundimet që i ka nxjerr grupi punues për shqyrtimin e peticioneve, sipas kërkesave të Veli Karagjës, Agim Vatovcit, Meleq Ymerit, miratohen nga komisioni, ndërsa lidhur me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, që të shqyrtojmë peticionin e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, kemi vendosur si komision ta shqyrtojmë mbas datës së 17 shkurtit 2018. Sa i përket peticionit për Inspektoratin Policor, Komisioni për Punë të Brendshme ka ftuar ministrin e Punëve të

Brendshme në raportim dhe ne mundemi të marrim pjesë në mbledhje të këtij komisioni dhe të shohim veprimet e mëtejshme të Komisionit për Punë të Brendshme.

## **5. Të ndryshme**

**Kryetarja**, njoftoi anëtarët e komisionit se kemi pranuar një ftesë nga Kryegjyshata Botërore e Shqipërisë për një vizitë në Shqipëri, lidhur me Projektligjin për lirinë fetare në Kosovë, me dt. 23 deri 26 shkurt, do të përgatisim shkresën për Kryesi dhe do ta realizojmë këtë vizitë, e cila është e një rëndësie të veçantë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje